



**VOLKSHOCHSCHULE OÖ**  
INSTITUT INTERKULTURELLE  
PÄDAGOGIK


**zusammen-bilden**

Bulgariplatz 12  
4020 Linz  
0732/ 66 11 71-42  
[institut@vhs-ooe.at](mailto:institut@vhs-ooe.at)



# Instituti ndërkulturore pedagogjike Volkshochschule në Austriinë e sipërme

Li nav përzimanî ye zimanekë li gel hev dibîne.



Instituti ndërkulturore pedagogjike është një pjesë e institucionit kryesor arsimor „Volkshochschule OÖ“, që merret me pedagogji dhe punë sociale. Instituti ndërkulturore pedagogjike arrin përafërsisht deri 350 kurse dhe poashtu ligjerata të ndryshme, ku përafërsisht 4000 pjesëmarrës në vitë mund të mbështeten në përvojën ndërkulturore shumë vjeçare të tij, si dhe të krijojë qasje tek grupet ku kanë më shumë vështirësi.

## Qëllimet kryesore apo angazhimi kryesor

Çështja kryesore e institutit ndërkulturore pedagogjike është që komunave në Austriinë e sipërme, institucioneve arsimore dhe institucioneve të emigrantëve të ju qëndroj pranë për çfarë do që kanë nevojë. Të ju ndihmojë prindërve në aspektin e integritetit të tyre dhe të fëmijëve, që të kenë mbështetje në aspektin pedagogjike dhe arsimor poashtu të zhvillojnë kompetencat e tyre, që pastaj fëmijet ta kenë më të lehtë startimin në shkollë dhe të kyqen më lehtë në sistemin austriak shkollor. Instituti ndërkulturore pedagogjike përpaket të përmirësojë mundësit arsimore për të gjithë ata që kanë nevojë dhe poashtu instituti përpaket për bashkëpunim social dhe integrim social gjithë përfshirës.

## Grupet e synuara

Në grupet e synuara në radhë të parë janë prindërit me fëmijet e tyre të cilët nuk kanë orientim në Austri apo përshkak imigrimit të tyre prej vendeve të ndryshme prej ku kanë ardhur dhe për atë ne i'u kushtohemi atyre më shumë, që ti mbështesim ku kanë më së shumti nevojë.

## Ofertat/Përkrahje

Ofertat e institutit ndërkulturore pedagogjike mbahen në Austriinë e sipërme ku mund të drejtohen të gjitha moshat. Instituti ndërkulturore pedagogjike përfshinë katër detyra themelore, të cilat zbatohen në programe të ndryshme:

- Mbështetje/Përkrahje e hershme tek fëmijet
- Mbështetje/Përkrahje në mësim
- Mbështetje/Përkrahje në gjuhë
- Angazhimi i prindërve në institucione arsimore të fëmijëve të tyre

Këto oferta ofrohen dhe zhvillohen përmes shtetit austriak dhe komunave të ndryshme të Austrisë së sipërme. Në institutin ndërkulturore pedagogjike janë mbi 200 referente/referent dhe kujdestar për fëmijë të punësuar. Shumica prej tyre zotojnë shumë gjuhë të ndryshme dhe kanë përvojë ndërkulturore. Kjo përvojë e tyre është në favor për institutin tonë.



**ist** Integrationsstelle  
Oberösterreich

Albanisch